



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



THIRRJE PUBLIKE

**Për Mbështetje Financiare Publike të
Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve Rinore**

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për Projektet që kontribuojnë për zbatimin e aktiviteteve, fuqizimin dhe zhvillimin e pjesëmarrjes së të rinjve të Komunës së Gjakovës.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

a. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e rinisë.

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me Projektet që kontribuojnë për zbatimin e aktiviteteve, fuqizimin dhe zhvillimin e pjesëmarrjes së të rinjve si me poshtë:

- a. Promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes;
- b. Përkrahje në fushën e edukimit jo-formal;
- c. Promovimi i punës vullnetare dhe punës praktike;
- d. Promovimi i mjedisit të sigurtë dhe parandalimi i sjelljeve të rrezikshme dhe
- e. Promovimi i barazisë gjinore, mos-diskriminimit dhe integritetit shoqëror.

4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projektet individuale është 250.00 Euro.

5. Afati për dorëzimin e propozimeve është jo më pak se 15 ditë pune, duke filluar nga data **21.04.2022** dhe përfundon me datën: **17.05.2022**

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

7. Së bashku me aplikacionin, OJQ-të janë të obliguara të paraqesin dëshminë e Vërtetimit Tatimor të ATK-së dhe Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike të OJQ-së. Nëse këto dokumente nuk paraqiten me rastin e aplikimit atëherë aplikacioni konsiderohet i pavlefshëm.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (kk.rks-gov.net/gjakove/).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Adresa: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS-së

